REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1116/20
Datë/Datum. 21.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 701-20-5712-5-1-1

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BM Group Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkupi Bll.05 ,Linda Premium Residence, L9, pn , 10000 Prishtinë, Kosovë
(Adresa)

Prishtine *(Vendi)*

10000 *(Kodi postar)*

+383 49 247680 *(Numri Telefonit)*

N/A *(Numri i Faks-it)*

Bedri Gllareva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bedri.gllareva@bmgroup-rks.com; *info@bmgroup-rks.com*
(Adresa elektronike)

18.12.2020 _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

BM GROUP SH.P.K. Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë si dhe Dosja e Tenderit janë publikuar me datën 28.09.2020 në faqen zyrtare e-prokurimi.rks-gov.net prej nga edhe i kemi shkarkuar Dosjen e Tenderit dhe Paramasën.

Dorëzimi i dosjes nga kompania jonë është bërë me datën 06.11.2020 në mënyrë elektronike përmes e-prokurimi.rks-gov.net. Procesi i hapjës së tenderit është bërë me datë 06.11.2020 nga ora 13:00.

Me datën 03.12.2020 AK ka publikuar "B 58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net, ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur Konsorciumi Grup iOperatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k.; Beni-Dona Gr, Sinani-ING Sh.p.k

Me datën 03.12.2020 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratë dhe qasja na eshte aprovuar permes emailit te datë 04.12.2020.. Dhe konform aprovimit me datë 07.12.2020 kemi pasur qasje në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratës.

Me datë 11.12.2020 përmes emailit dhe faqes së e-prokurimit kemi pranuar Përgjigjjen per Kërkesën për rishqyrtim nga AK. AK ka marrë vendim që të Refuzohet kërkesa për rishqyrtim dhe të vazhdohet me vendimin per kontrate si fitues është shpallur

Konsorciumi Grup iOperatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k.; Beni-Dona Gr, Sinani-ING Sh.p.k.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ankesa jonë ka të bëjë me Ri-shikimin në përcaktimin e Operatorit Ekonomik fitues, kështu që mendojmë që AK :

KA BËRË SHKELJE TË LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË NENET E MËPOSHTME:

Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7– Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

JU AK me datën 03.12.2020 keni publikuar formularin –vendimin "B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net, me të cilen keni propozuar për kontratë Konsorciumin-Grupin e Operatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k & Beni-Dona Gr & Sinani-ING Sh.p.k

Me kete vendimin ju AK respektivisht komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me neni 7 të LPP-së duke mos trajtuar barabartë respektivisht duke favorizuar oferten e konzorcimuit te rekomanduar për kontratë sepse për kunder që ky konzorcium ka qenë i papërgjegjshem sepse nuk i ka plotësuar kërkesat e parashtruara nga ju vetë AK në DT dhe NJK sepse ju keni kërkuar që operatoret ekonomik të dëshmojn se në tri vitet e shkura nga data e publimimit te ketije aktiviteti te ketë të përfunduara kontrata te natyres se ngjajshme(ndertime te larta) te percjellura me referenca apo raporte pranimi vlera e te cilave duhet te jetë minimum 5,000,000.00 €, ndersa i njeti konzorcium nuk ka ofruar deshmi të mjaftushme se gjate periudhes- tri vitet e shkura nga data e publikimit te ketije aktiviteti te ketë të përfunduara kontrata te natyres se ngjajshme(ndertime te larta) te percjellura me referenca apo raporte pranimi ne minimum prej 5,000,000.00 €, perkunder kesaj ju e keni favorizuar kete konzorcium dhe keni diskrimnuar oferten tonë me të cilen i plotësojm të gjitha kërkesat e parashtruara nga ana e juaj në DT dhe NJK.

Me vendimin me të cilin ju AK respektivisht komisioni i vlersimit keni rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k & Beni-Dona Gr & Sinani-ING Sh.p.k keni vepruar ne kundershtim të plotë edhe me nenit 59 të LPP-së me te cilin qarte specifkohet se "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" pasi që ju keni parashtruar kërkesen në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si vijon:
"Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €."

dhe
"Dëshmia 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduar me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellur me referenca apo raporte te pranimit ku vlera e te cilave duhet te jete minimum 5,000,000.00 €. Lista duhet ti permbaje te dhenat si Daten e nenshkrimit, Daten e perfundimit, Titullin e Kontrates, Autoritetin Kontraktues, Vleren e projektit."

Ndersa grupi i operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar listat e projekteve të realizuara nga secili antar i konzorciumit mirëpo asnjëra nga këto lista nuk është konform kërkeses së AK sepse në to nuk është paraqtur Data e nenshkrimit dhe Data e perfundimit te kontratave por vetem janë paraqitur viti i fillimit dhe viti i mbarimit te kontrates e per disa kontrata është përshkruar vetem viti pa cekur se a është viti i fillimit apo përfundimit të kontrates.

Ne listat e projekteve të realizuara nga antaret e konzorciumit janë përfshirë kontrata të realizuara nga viti 2008 deri në vitin 2020, nese mblidhen vlerat e kontratave te paraqitura ne lista ateher vlera e përbashket e kontratave te paraqitur nga konzorciumi i rekomanduar per kontrate është 40,026,404.45 €, mirëpo publikimi i këtij aktivitet te prokurimit nga ju-AK është bërë me datën 28.09.2020 dhe kërkesa ka qenë që operatoret ekonomik duhet të ofrojn deshmi që kanë perfunduar kontrata te ndertimit te larte me sukses ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit te percjellura me refernca apo raporte pranimi, ndersa ju-AK respektivisht komisioni i vlersimit keni marr për bazë vlerat e kontratave të cilat janë të përfshira ne lista e të cilat kanë përfunduar para dates 28.09.2017 date e cila paraqet fillimin e periudhes se tri viteve te shkuara nga data e publikimit te ketije aktiviteti sipas kerekese tuaj. Perveq vlerave te atyre kontratave që nuk i perkasin periudhes së 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit përkontratë, po ashtu konzorciumi ne fjale për periudhen e fundit 3 vjeqare në lista kanë përfshirë vlerat e kontratave të cilat kanë të bëjnë me renovime, furnizime, montime, kontratat e kompleksëve banesore pa pranime teknike nga institucione kompetene –komisione profesionael te Komunave-Bashkive (por janë bashkangjit raporte te inxhinierve për vetë OE) si dhe shume vlera të kontratave të cilat janë në implementim e sipër (të pa përfunduara), të gjitha keto kontrata respektivisht vlera te ketyre kontratave nuk janë konform kërkesës së parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nga ju- AK, ku është kërkuar që operatoret ekonomik duhet të ofrojnë një listë te kontratave te natyrës se ngjashme (ndertime te larta) te përfunduara me sukses në tre vitet e shkuara nga data e publikimit te këtij njoftimit për kontratë, te percjellura me referenca apo raporte të pranimit ku vlera e të cilave duhet të jetë minimum 5,000,000.00 €, dhe si te tilla është dashur të mos merren për bazë dhe as mos të favorizohet ky konzorcium nga ana e komisionit të vlerësimit.

Nga listat e projekteve të realizuara te paraqitura nga lideri i konzorciumit OE "Olti Trasing"Sh.p.k. dhe antari i konzoriciumit Sinani-ING Sh.p.k janë përfshirë vetem disa projekte të cilat kanë përfunduar dhe për te cilat janë bashkangjitur referenca/pranime teknike si dhe i takojn periudhes së fundit 3 vjeqare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (28.09.2017 deri 28.09.2020), këto projekte janë:

Ndërtimi i një etazhe (nen kulem) në DR.Ferizaj Salla operative	98,840.98 €
Ndertimi i pikes O në Burgun e siguris së lartë	64,531.02 €
Ndërtimi i aneksit te objektit të Gjimnazit "Hamdi Berisha" Malishevë	256,060.67 €
Ndertimi i katit të tretë në DR Prizren	219,226.36 €
Ndertimi i ndërteses së IKAP-it LOT 10	1,643,051.43 €

Ndertimi i ndërteses së IKAP-it punë të pa parapara Aneks Kontratë	38,022.36 €
Ndertimi i Prokuroris Themelore Gjakove	493,092.35 €
Ndertimi i shkolles fillore ne Muzeqin	659,989.80 €
Ndertimi i shkolles fillore "Afrim Buqaj" ne fsh.Lladroc	278,801.79 €
Aneks kontrata Ndertimi i shkolles fillore "Afrim Buqaj" ne fsh.Lladroc	27,877.34 €
Vlera totale e ketyre kontratave është =	3,779,494.10 €

Mirëpo vlera e ketyre kontratave nuk e plotësojnë kërkesen e juaj te parashtruar në DT dhe NJK minimum 5,000,000.00 €.

Ju-AK keni rekomanduar për kontratë konzorciumin i cili nuk e plotëson as kërkesat e pershtatshmeris sepse antari i konzorciumit "Beni-Dona Grup" nuk ka dorëzuar dëshmit e kërkuara nga ana e juaj kopjet e certifikates se biznesit, kopjen e numrit fiskal dhe as kopjen e certifikates se TVSH, ndersa sipas legjislacionit dhe praktikave te prokurimit te gjithe antaret e konzorciumeve duhet te plotesojn veq e veq kerkesat e pershtatshmeris për këtë operator ekonomik "Beni-Dona Grup" është bashkangjitur një kopje te "Ekstraktit historik i regjistrit tregtar per te dhenat e subjektit" Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" e cila ka date te leshimit 28.06.2020 mirëpo nuk ka as nënshkrim te zyrtarit dhe as vulë të institucionit për të konstatuar se kush e ka leshuar dokumentin në fjalë.

Me rastin e rekomandimit per kontrate te Konsorciumin-Grupin e Operatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k & Beni-Dona Gr & Sinani-ING Sh.p.k, ju-AK respektivisht komisioni i vlersimit ka vepruar ne kundershtim me kriterin e percaktuar nga ju ne DT dhe NJK "Çmimi më i ulët" me qe rast keni vepruar edhe në kundërshtim me kriterin e percaktuar edhe me paragrafin 1.1 te pikes 1 te nenit 60 të LPP-së ku qarte percaktohet se "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Me rastin e rekomandimit per kontrate te Konsorciumin-Grupin e Operatorve Ekonomik "OLTI – Trasing Sh.p.k & Beni-Dona Gr & Sinani-ING Sh.p.k, ju-AK respektivisht komisioni i vlersimit ka vepruar ne kundershtim edhe me nenin 1 të LPP-së me të cilin qartë përcaktohet se qëllimi i LPP-së është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla si dhe kanë vepruar në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 6 të LPP-së ku qartë përcaktohet se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Nga faktet e cekura më lartë qartë konstatohet se ju- AK respektivisht komisioni i vlersimit nuk ka vepruar sipas kerkesave dhe kritereve të përcaktuar në NJK dhe DT , duke mos i trajtuar barabart te gjitha ofertat dhe duke favorizuar konzorciumin e rekomanduar per kontrate nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, me rastin e vlersimit të ofertave.

Sipas AK në vendimin e lëshuar me datë 11.12.2020 ku kërkesën tonë e shpall të pa

bazuar me arsyetimin se OE i propozuar për dhenie te kontratës ka ndërtime të objekteve private ne vlere mbi 8 milion. Duke u bazuar në ligjë projektet e vet financuara nga OE nuk munden të merren parasysh pasiqë OE nuk mundet vehtevetes ti lëshoj Reference pozitive për punët e kryera sepse eshte konflikt interesi dhe ne kundërshtim me ligjin neni Neni 7– Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi. Sikur të kishte qenë ashtu, çdo operator ekonomik do ti kishte lëshu Referenca pozitive vehtes dhe atëherë ligji nuk do ishte përfille dhe këtë kriter (5,000,000.00 euro pune te kryera) qdo OE i mundshem dhe joipergjegjshëm do e kishte plotësu.

Meqenë se ne kemi dorëzuar oferten e përgjegjshme konform kërkesave të parashtruara ne DT dhe NJK dhe me çmim më të lirë se sa opertoret tjerë të përgjegjshëm pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit, kërkojm nga ju-AK që me rastin shqyrtimit të kërkeses tonë për rishqyrtim lidhur me aktiviteti i prokurimit: " Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji "me nr.të Aktivitetit të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1 të merrni këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e OE "BM GROUP" Sh.p.k.,-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin:"Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji "me nr.të Aktivitetit të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1.

2. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës lidhuir me aktivitetin e prokurimti: " Ndërtimi i objektit për klinikat Nefrologji dhe Hemato-Onkologji "me nr.të Aktivitetit të prokurimit: 701-20-5712-5-1-1 dhe lenda kthehet në Ri-vlerësim.

Me rastin e Ri-vlerësimit të ofertave të merret vendim me te cilen rekomandohet për kontratë OE "BM GROUP" Sh.p.k.,-Prishtinë e cila ke dorëzuar oferten e përgjegjshme administrativisht konform kërkesave të parashtruara ne DT dhe NJK dhe me çmim më të lirë se sa opertoret tjerë të përgjegjshëm pjesmarres në këtë aktivitet të prokurimit,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
c) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë;
d) Kerkesa per rishqyrtim e dorezuar tek AK
e) Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*